

Vorlesen und Erzählen **3**

für Kinder ab **3**

Lexim më zë të lartë dhe tregim për fëmijë që nga mosha 3 vjeç



Shqip | Albanisch



GEFÖRDERT VOM



Bundesministerium
für Bildung
und Forschung

Stiftung Lesen

Të dashur prindër,

a mbani mend akoma? Për përkujdesjen U6 dhe U7 ju keni marrë tek mjeku juaj i fëmijëve complete për nisjen e leximit. Mjeku juaj ose mjekja juaj ju ka shpjeguar se si ju me leximin me zë të lartë dhe tregimin e rregullt e përkrahni fëmijën tuaj.

Në bibliotekën tuaj ju e keni marrë tashmë kompletin e nisjes së leximit për fëmijë që nga tre vjeç. Atje gjeni akoma më shumë libra me figura dhe media të tjera për t'i marrë hua: për shembull DVD, lojëra dhe libra akustikë.

Në broshurën „Lexim me zë të lartë dhe tregim për fëmijë që nga mosha 3 vjeç“ ju gjeni përsëri shumë këshilla praktike për leximin me zë të lartë.

Dhe me librin e ri me figura ju mund të filloni menjëherë të lexoni me zë të lartë. Kjo me siguri i jep fëmijës suaj shumë kënaqësi.

Ne ju urojmë juve shumë kënaqësi gjatë leximit me zë të lartë dhe tregimit së bashku.



Ministria juaj Federale e
Arsimit dhe Kërkimit
Shkencor

Fondacioni juaj Leximi

Përmbajtja

- 4 Si mund ta mbështes unë fëmijën tim gjatë të folurit?
- 6 Si lexoj unë më së miri me zë të lartë?
- 8 Fëmija im është tepër i paqetë për leximin me zë të lartë – dhe tani?
- 10 Dhe çfarë është me mediat e tjera?
- 12 Cilat libra janë të përshtatshëm për fëmijën tim?



Si mund ta mbështes unë fëmijën tim gjatë të folurit?

Fëmija juaj ndërkohë njih shumë fjalë. Në vitet e para të jetës ai ka mësuar, që fjalët në një radhë të caktuar formojnë një fjali. Ai përdor gjithnjë e më shumë fjalë, të cilat përshkruajnë se çfarë ai bën, dhe ai shtron pyetjet e para.



Fëmija juaj kupton, përse ndodh diçka, çfarë ndodh në fillim dhe çfarë më vonë. Me fjalorin e tij në rritje fëmija juaj mund të tregojë gjithnjë e më mirë, se çfarë dëshiron.

Është e rëndësishme, që ju të flisni shumë me fëmijën tuaj. Bëjini pyetje atij. Kështu zhvillohet një bisedë midis jush dhe fëmijës suaj. Gjatë kësaj ai ndihet mirë dhe vëren, që ju gjeni kohë për atë.



Mendoni për këtë: Çdo fëmijë zhvillohet ndryshe dhe mëson me shpejtësi të ndryshme!



Këshilla 1: Hajde, ne tregojmë!

Provojeni këtë menjëherë me librin e nisjes së leximit:

Bëjini pyetje fëmijës suaj gjatë leximit me zë të lartë:

- Çfarë po ndodh atje?
- Çfarë mund të zbulohet?
- Çfarë të pëlqen ty më shumë?

Inkurajoni fëmijën tuaj, që ai t'ju tregojë, atë çfarë sapo i keni lexuar ju atij me zë të lartë. Ose sajoni së bashku një histori të re.



Si lexoj unë më së miri me zë të lartë?

Gjatë leximit me zë lartë nuk ka mënyra të drejta ose të gabuara!

Leximi me zë të lartë nuk është aspak i vështirë dhe bëhet shumë thjeshtë! Dhe më së miri funksionon, nëse të gjithë ndihen mirë gjatë kësaj.

Ju mund ta ndryshoni zërin tuaj, mund të lexoni me zë të lartë dhe të ulët, ngadalë dhe

shpejt – por nuk duhet patjetër ta bëni këtë. Fëmijëve u pëlqen që t'u lexohet atyre me zë të lartë, ska rëndësi si e qysh!



Leximi me zë të lartë përshtatet në çdo jetë të përditshme!



Pikërisht në situata të stresuara ju mendoni ndoshta shpesh herë: Tani unë duhet të lexoj edhe me zë të lartë, a duhet kjo?

Mos keni merak, leximi me zë të lartë nuk duhet doemos të zgjasë gjatë. Dhe ai shpesh sjell çlodhje. Histori të shkurta mund të integrohen thjeshtë në jetën e përditshme, p.sh.

gjatë pritjes për autobusin, tek mjeku ose para shtrimit për të fjetur.

Në një vështrim: Gjithçka çfarë bën leximi me zë të lartë ...

- Leximi me zë të lartë e mbështet fëmijën tuaj gjatë mësimit të të folurit
- Ai krijon afërsi
- Leximi me zë të lartë i jep fëmijës suaj guxim, që të shprehë ndjenjat e tij
- Leximi me zë të lartë i ndihmon fëmijët, që të kuptojnë njerëzit e tjerë
- Ai i ndihmon fëmijës suaj, që të përqendrohet
- Ai e stimulon fantazinë
- Leximi me zë të lartë të bën të zgjuar

... dhe leximi me zë të lartë thjesht jep shumë kënaqësi!



Fëmija im është tepër i paqetë për leximin me zë të lartë – dhe tani?

Nëse fëmija juaj gjatë leximit me zë të lartë bëhet i paqetë, atëherë integrojeni atë: Shtroni pyetje ose përshkruani së bashku figurat.

Ngandonjëherë edhe ndihmon, që të lini fëmijën tuaj të bëjë pak potere. Pastaj ai ka më shumë qetësi, që të shikojë bashkë me ju libra.

Dhe nëse nuk shkon asgjë, ju e mbyllni librin dhe lexoni thjesht më vonë.



A duhet të lexoj unë me zë të lartë gjermanisht?

Jo! Shumë gjëra, që fëmija juaj mëson gjatë leximit me zë të lartë dhe tregimit nuk janë të lidhura me një gjuhë të caktuar.

Bëjeni atë me kënaqësi në atë gjuhë, në të cilën ju flisni edhe zakonisht me fëmijën tuaj.



Këshilla 2: Leximi me zë të lartë është edhe shumë më shumë!

Histori janë një pikënisje e mrekullueshme, për të bërë punë-dore, pikturuar ose për të kënduar një këngë së bashku.

- Për mësimin e shkrimit pikturimi është hapi i parë.
- Të dëgjosh këngë dhe të këndosh, kjo aktivizon shumë sfera në tru.
Nëse ju këndonit së bashku, ju e ndihmoni fëmijën tuaj, që të shprehet gjithnjë e më mirë.



Dhe çfarë është me mediat e tjera?

Fëmijët dashurojnë celularë, tablete dhe të ngjashmet. Aq më mirë, që shumë oferta digjitale janë të përshtatshme, për të ushtruar në formë loje leximin me zë të lartë dhe të folurit. Me rëndësi është, që prindërit ta dinjë, se cilat media janë të përshtatshme për fëmijët e tyre.

Dhe sa kohë ato mund të përdoren pa i mbingarkuar fëmijët.

Leximi me zë të lartë dhe të luajturit me aplikacione

Ndërkohë ka shumë aplikacione me libra fëmijësh. Përveç një historie të vogël këto aplikacione ofrojnë edhe shumë elemente për pjesëmarrje dhe lojëra të vogla.

Leximi me zë të lartë me libra akustikë

Por nëse ju nganjëherë nuk keni kohë për leximin me zë të lartë, atëherë librat akustikë ose emisionet për fëmijë në radio janë një alternativë.



Shumë media digjitale ju i gjeni edhe në bibliotekën tuaj për t'i marr hua.



Këshilla 3: Përdorni mediat në mënyrë të arsyeshme.



Specialistët rekomandojnë: Fëmijët që nga tre vjeç duhet të kalojnë një gjysmë orë maksimumi para televizorit, kompjuterit ose me media të tjera.


Sepse fëmijët e vegjël nuk mund t'i përpunojnë aq mirë videot dhe imazhet e lëvizshme.



Më mirë t'i zbuloni mediat së bashku me fëmijën tuaj. Ndhimoheni atë, që të orientohet. Caktoni rregulla të qarta se kur, ku dhe për sa kohë mund të përdoren mediat.



Mediat digjitale mund t'i plotësojnë librat. Ato mund të jenë një variacion i bukur gjatë udhëtimeve, në rast të kohëve të pritjes ose për fëmijë dhe prindër të apasionuar për teknikën.



Cilat libra janë të përshtatshëm për fëmijën tim?

Çdo fëmijë është ndryshe! Prandaj lini që edhe fëmija juaj t'i zgjedhë bashkë me ju librat, për të cilët ai interesohet.

Pothuajse të gjithë fëmijët pëlqejnë veçanërisht figura të kafshëve dhe histori tematike.

Shumë fëmijë pëlqejnë edhe libra me figura, të cilat i njohin nga televizori ose nga interneti.


Jo më vonë sesa në Kita bëhen edhe tema të tjera interesante si miqësia dhe jeta e përditshme.

Vjershat me rimë dhe këngët e zgjojnë dëshirën për të luajtur me gjuhën. Librat e parë tematikë me shumë figura dhe librat me shumë figura të vogla e nxisin kënaqësinë në zbulimin.





Këshilla 4: Këtu ka libra me figura dhe histori



Shumë informacione dhe këshilla ka në www.lesestart.de. Atje i gjeni edhe të gjithë librat e nisjes së leximit.



Histori për të lexuar me zë të lartë në smartphone ose tablet ka falas në www.einfachvorlesen.de.

Librat e përshtatshëm me figura, edhe në gjuhë të tjera sesa në gjermanisht, ju i gjeni në bibliotekë ose në librari.



Vorlesen und Erzählen für Kinder ab 3

Impressum

Herausgeber und Verleger: Stiftung Lesen, Mainz | Verantwortlich: Dr. Jörg F. Maas
Programme: Sabine Uehlein | Projektleitung: Sabine Bonewitz | Redaktion: Ulrike Annick Weber
Grafik/Illustration/Druckvorstufe: Melanie Freund, Mainz | Übersetzungen: Engin GmbH, Frankfurt/
Edition Orient, Berlin | © Stiftung Lesen/Lesestart/Fotografen: Tamara Jung-König (S. 2, 4, 6, 8)
Gordon Welters (Titelmotiv, S. 2, 6, 10, 11, U3)
Druck: ppm Fulda GmbH & Co. KG, Frankfurter Straße 8, 36043 Fulda
2. Auflage: 500.000

© Stiftung Lesen 2023





www.lesestart.de

Stiftung Lesen

Römerwall 40
55131 Mainz

Kostenfreie Lesestart-Servicehotline: **0800 3103103** (aus dem dt. Festnetz)

E-Mail: info@lesestart.de



[@lesestart123](https://www.instagram.com/lesestart123)



www.facebook.com/Lesestart



www.pinterest.com/lesestart123